



Senati i Universitetit të Prishtinës shpall:

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor për vitin akademik
2026/2027

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 20, pika 2, nënpika 2.2, dhe në zbatim të nenit 98, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2026, ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2026/27 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet themelore - baçelor.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik 2026/2027, do të regjistrojë **5663** studentë të rregullt.
2. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet themelore - baçelor kanë të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë dhe kanë kaluar testin e Maturës Shtetërore.
3. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI-t, universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **659** studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej **12%** e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
4. Në universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të pranohen deri në **2%**, përkatësisht deri në **115** kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, deri në **2%**, përkatësisht deri në **116** nga Maqedonia e Veriut dhe Republika e Shqipërisë dhe deri në **1%**, përkatësisht deri në **71** kandidatë nga Mali i Zi.
5. Me vendim të Senatit, me nr. prot. 764, të aprovuar nga MASHTI, Universiteti i Prishtinës, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, do t'u ofrojë kuota të vendeve të rezervuara edhe pjesëtarëve të komunitetit të arbëreshëve të Italisë dhe arbënesëve të Zarës deri në **1%**, përkatësisht deri **64** kandidatë, shqiptarëve të Turqisë deri në **1%**, përkatësisht deri **62** kandidatë dhe mërgatës shqiptare me prejardhje nga Kosova deri në **2%** përkatësisht deri **112** kandidatë.

6. Kandidatë jokosovarë, si dhe kandidatë nga komuniteti i arbëreshëve të Italisë, arbneshëve të Zarës, shqiptarëve të Turqisë dhe mërgatës shqiptare me origjinë nga Kosova konsiderohen ata që kanë lindur jashtë Kosovës dhe poashtu shkollimin paraprak e kanë përfunduar jashtë Kosovës.
7. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit, do t'ua shtojë nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
8. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
9. Në universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
10. Lejohet aplikimi i kandidatëve, të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm para zbatimit të Testit të Maturës ose në vendet prej nga vijnë nuk zbatohet Testi i Maturës. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm jashtë Republikës së Kosovës, diploma duhet të jetë e njohur dhe e barasvlerësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Kosovës, përmes vendimit përkatës për njohje dhe barasvlerësim. Barasvlera e notave do të bëhet në njësinë akademike përkatëse nga koordinatori për zhvillim akademik.
11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën, në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim, përveç në rastet specifike, ku testi do të përgatitet në gjuhën, në të cilën zhvillohet programi (p.sh. në programet e Fakultetit të Filologjisë: Gjuhë dhe Letërsi Angleze; Gjuhë dhe Letërsi Gjermane; Gjuhë dhe Letërsi Frënge; Gjuhë dhe Letërsi Turke dhe Orientalistikë).
12. Njësitë akademike përkatëse, me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti joshumicë, bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik, duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. **Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetëdeklarim, sipas nenit 391 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale. Kandidati/ja që, mbi bazën e deklaramit të rrejshëm apo dokumentacionit të falsifikuar, ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në Universitetin e Prishtinës, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga Universiteti i Prishtinës, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë.**
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2026/27 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se një fakultet, departament, drejtim apo program.**

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arkitekturës, do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara më poshtë.
Për Fakultetin e Arkitekturës, përzgjedhja është pasqyruar te Fakulteti i Arkitekturës.

- a) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b) **Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë dhe
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues, deri në numrin e paraparë sipas konkursit.**
 3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
 4. **Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriterëve të përcaktuara si në paragrafët 3, 4 dhe 5 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
 5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
 6. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
 7. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar t’ia dërgojnë rektoratit të universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e fakultetit.
 8. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimit ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve.
 9. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - a) Kandidati/ja i/e cili/a ka rezultat më të mirë të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta;
 - b) Kandidati/ja i/e cili/a ka sukses më të mirë të shkollës së mesme, e nëse edhe pikët e provimit pranues dhe të suksesit të shkollës së mesme janë të njëjta;
 - c) Kandidati/ja i/e cili/a ka rezultat më të mirë nga testi i maturës.
 - d) Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përzgjedhja e kandidatit/es fitues do të bëhet përmes tërheqjes së shortit në prani të kandidatëve me pikë të barabarta si në paragrafët a), b) dhe c) të pikës 9.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> do të jetë i hapur prej datës **29.06.2026 deri më 06.07.2026** në orën 16:00.
2. Ditën e parë të konkursit, më **29.06.2026**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **14:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët, të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **29.06.2026** deri më **06.07.2026**. Gjatë kësaj periudhe, gjithashtu do të bëhet verifikimi i

dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës. Dokumentacioni do të pranohet çdo ditë, me përjashtim të të dielave.

4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj;*
 - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose të noterizuara);*
 - c) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
 - d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, dublikatë ose e noterizuar);*
 - e) *Kopjen e letërnjoftimit;*
 - f) *Të ngarkohet një fotografi profesionale, të realizuar në fotostudio, sipas standardeve për dokumente zyrtare (si fotografia për pasaportë ose vizë). Fotografia duhet të jetë me dimensione 35 × 45 mm, me fytyrën ballë përballë, sfond të bardhë ose të pastër dhe të ruhet në formatin JPG, JPEG ose PNG.*
 - g) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>;***
 - h) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*

1. **Me rastin e aplikimit në datat e caktuara si në pikën 3 të kapitullit III, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 5 të këtij kapitulli t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.**
2. **Nëse gjatë aplikimit online, kandidati gabimisht aplikon në një program tjetër studimor, atëherë duhet të kërkojë nga zyrtari i TI-së i fakultetit përkatës t'i fshihet aplikimi i gabuar nga sistemi, në mënyrë që t'i mundësohet procedura e aplikimit nga fillimi. Kjo procedurë duhet të përfundojë para datës së mbylljes të aplikimit online.**
3. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë për aplikim fizik, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.
4. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në uebfaqet e këtyre fakulteteve.
5. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të paraqitura si më poshtë:

Grupi I:

1. Fakulteti Filozofik, me datë **08.07.2026**, në orën **9:00**;
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, me datë **08.07.2026**, fillon në orën **14:00**;
3. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, me datë **08.07.2026** dhe **09.07.2026**, në orën **8:00**;
4. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, me datë **08.07.2026**, fillon në orën **14:00**;
5. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, me datë **08.07.2026**, në orën **9:00**;
6. Fakulteti Juridik, me datë **08.07.2026**, në orën **9:00**;
7. Fakulteti i Arteve, me datë **08.07.2026**, **09.07.2026** dhe **10.07.2026**, në orën **9:00**;
8. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, me datë **08.07.2026**, në orën **10:00**;
9. Fakulteti i Arkitekturës, me datë **08.07.2026**, fillon në orën **09:00**.

Grupi II:

1. Fakulteti i Filologjisë, me datë **09.07.2026**, në orën **9:00** dhe **11:00**;
2. Fakulteti i Ekonomisë, me datë **09.07.2026**, në orën **10:00**;
3. Fakulteti i Edukimit, me datë **09.07.2026**, në orën **9:00**;
4. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, me datë **09.07.2026**, fillon në orën **9:00**.

Grupi III:

1. Fakulteti i Mjekësisë, me datë **11.07.2026**, duke filluar nga ora **9:00**.
6. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të kenë me vete letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
7. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse më së largu me datë **11.07.2026** në ora **16:00**. Fakulteti i Mjekësisë më së largu me datë **12.07.2026** në ora **16:00**.
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet më lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët, të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare**, respektivisht më **13.07.2026** dhe **14.07.2026** në ora **16:00**.
3. Pas afatit të përcaktuar si në pikën e sipërshënuar, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet menjëherë pas mbylljes së afatit ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
2. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **15.07.2026-17.07.2026 (3 ditë pune)**.
3. Kandidatët të cilët kanë kaluar pragun e kalueshmërisë të përcaktuar si në pjesën II (Mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve), paragrafët 3 dhe 4 të këtij konkursi, mirëpo për arsye se janë plotësuar të gjitha vendet e parapara në programin në të cilin kanë aplikuar, të njëjtit kanë ngelur jashtë listave të kandidatëve të pranuar, atëherë bazuar në ranglistën sipas pikëve të grumbulluara, të njëjtit mund të pranohen në programet studimore brenda njësisë akademike, në të cilat kanë mbetur vende të lira nga afati i parë i konkursit, me kusht që të kenë pasur testet e njëjta të provimit pranues.

4. Pranimi i kandidatëve si në paragrafin 3 të kësaj pike do të bëhet vetëm pas shprehjes së interesimit për pranim në programin përkatës.
5. **Në departamentet, drejtimet ose programet, ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**
6. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-pr.edu

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. **Shpallja e rezultateve përfundimtare** të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave, më së largu me datë **15.07.2026** në ora **16:00**.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

Regjistrimi i studentëve të pranuar realizohet në mënyrë automatike nga Administrata Qendrore, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga njësia akademike.

I. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **410** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatara shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Filozofik	322	47	8	8	6	5	5	9	410
Departamenti i Filozofisë	39	5	1	1	1	1	1	1	50
Programi Filozofi	39	5	1	1	1	1	1	1	50
Departamenti i Punës Sociale	32	4	1	1	1	0	0	1	40
Programi Punë Sociale	32	4	1	1	1	0	0	1	40
Departamenti i Historisë	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Histori	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Departamenti i Shkencës Politike	55	8	1	1	1	1	1	2	70

Programi Shkencë Politike: a) Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci b) Administrata Publike	55	8	1	1	1	1	1	2	70
Departamenti i Sociologjisë	56	8	1	1	1	1	1	1	70
Programi Sociologji	56	8	1	1	1	1	1	1	70
Departamenti i Psikologjisë	61	10	2	2	1	1	1	2	80
Programi Psikologji	61	10	2	2	1	1	1	2	80
Departamenti i Antropologjisë	32	5	1	1	0	0	0	1	40
Programi Antropologji dhe Trashëgimi Kulturorë	32	5	1	1	0	0	0	1	40

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë, nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës Sociale, nga Edukata qytetare, Psikologjia dhe Sociologjia dhe verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin e Historisë, nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Shkencave Politike, nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare;
- Në Departamentin e Sociologjisë, nga Sociologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Psikologjisë, nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime;
- Në Departamentin e Antropologjisë, nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **570** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandida të nga komunitetet joshumicë 12%	Kandid atë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandid atë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandid atë nga Mali i Zi 1%	Kandid atë nga arbëres hët e Italisë dhe arbnes hët e Zarës 1%	Kandid atë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandid atë nga mërgat a shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
SHMN	448	64	11	11	10	8	7	11	570
Departamenti i Matematikës	131	19	3	3	2	2	2	3	165
Programi Matematikë	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Shkencë Kompjuterike	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime	37	5	1	1	0	0	0	1	45
Departamenti i Fizikës	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Fizikë	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Departamenti i Kimisë	117	17	3	3	3	2	2	3	150
Programi Kimi	47	7	1	1	1	1	1	1	60

Programi Kimi Inxhinierike	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Kimi Ushqimore	23	3	1	1	1	0	0	1	30
Departamenti i Biologjisë	97	13	3	3	3	2	1	3	125
Programi Biologji	36	4	1	1	1	1	0	1	45
Programi Ekologji dhe Mbrojtje e mjedisit	38	6	1	1	1	1	1	1	50
Programi Biologji Molekulare	23	3	1	1	1	0	0	1	30
Departamenti i Gjeografisë	56	8	1	1	1	1	1	1	70
Programi Gjeografi	56	8	1	1	1	1	1	1	70

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës, nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës, nga Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Kimisë, nga Kimia, Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë, nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë, nga Gjeografia.

Në testet e provimit pranues, të cilat kanë detyra, krahas qarkimit të përgjigjes së saktë, duhet të ofrohet edhe zgjidhja e detyrës.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **565** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatara shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Filologjisë	467	70	12	12	6	6	5	12	590
Programi Gjuhë Shqipe	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Letërsi Shqipe	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze	97	14	2	2	1	1	1	2	120
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	97	14	2	2	1	1	1	2	120
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	28	4	1	1	0	0	0	1	35
Programi Gazetari	79	12	2	2	1	1	1	2	100
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	28	4	1	1	0	0	0	1	35
Programi Orientalistikë	23	4	1	1	0	0	0	1	30
Programi Ballkanistikë	21	4	1	1	1	1	0	1	30

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të departamentit përkatës të fakultetit:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe, nga Gjuha shqipe (me shkrim);

- Në Programin e Letërsisë Shqipe, nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge, nga Gjuha frënge (me shkrim);
- Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror dhe Ese.
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, nga Gjuha turke (me shkrim);
- Në Programin e Orientalistikës provimi pranues mbahet në formë testi nga këto lëmi: Gjuhë turke dhe arabe (njohuri elementare), Qytetërim islam, Kulturë orientale (me shkrim);
- Provimi pranues në Programin Ballkanistikë mbahet me shkrim nga gjuha amtare e kandidatit/ës dhe nga gjuha ballkanike, për t'u përcaktuar saktë niveli gjuhësor i kandidatit/ës.

Për kandidatët shqiptarë, gjuhë ballkanike është njëra nga gjuhët: BSKM (boshnjake, serbe, kroate, malazeze), ndërkaq për kandidatët joshqiptarë, gjuhë ballkanike në këtë program është gjuha shqipe.

IV. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **600** studentë të rregullt:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarisë 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatën shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Juridik	474	72	12	12	6	6	6	12	600

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së Drejtës, E Drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe.

V. FAKULTETI I EKONOMISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **1120** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarisë 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatën shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Ekonomisë	884	134	22	22	12	12	12	22	1120
Programi Banka dhe financa	237	36	6	6	3	3	3	6	300

Programi Menaxhment	199	30	5	5	2	2	2	5	250
Programi Marketing	117	18	3	3	2	2	2	3	150
Programi Ekonomiks	117	18	3	3	2	2	2	3	150
Programi i Kontabilitetit	176	26	4	4	2	2	2	4	220
Programi Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment (në Gjuhën Angleze), BSc	38	6	1	1	1	1	1	1	50

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për departamentet në gjuhën shqipe do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë.

Provimi pranues për programin Applied Economics and Management (BSc) do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë dhe Gjuhë angleze.

VI. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **220** studentë të rregullt dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatara shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	172	26	5	5	3	2	2	5	220
Departamenti i Konstruksioneve	88	13	2	2	1	1	1	2	110
Programi Konstruktiv	88	13	2	2	1	1	1	2	110
Departamenti i Hidroteknikës	24	3	1	1	0	0	0	1	30
Programi Hidroteknikë	24	3	1	1	0	0	0	1	30
Departamenti i Gjeodezisë	38	6	1	1	1	1	1	1	50
Programi Gjeodezi	38	6	1	1	1	1	1	1	50
Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit	22	4	1	1	1	0	0	1	30
Programi Inxhinieri e Ambientit	22	4	1	1	1	0	0	1	30

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimumi 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve, të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **510** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatoret shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
FIEK	404	61	10	10	5	5	5	10	510
Programi Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	199	30	5	5	2	2	2	5	250
Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	97	14	2	2	1	1	1	2	120
Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	61	10	2	2	1	1	1	2	80
Programi Elektroenergetikë	47	7	1	1	1	1	1	1	60

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet do të mbahet nga lënda: Matematikë.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **330** studentë të rregullt dhe atë sipas programeve si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatoret shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
FIM	259	39	6	6	5	5	5	5	330
Programi Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale	38	6	1	1	1	1	1	1	50
Programi Termoenergetikë dhe Energji e Ripërtëritshme	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Komunikacion dhe transport	56	8	1	1	1	1	1	1	70
Programi Mekatronikë	62	10	2	2	1	1	1	1	80
Programi Dizajn Inxhinierik dhe automjete	56	8	1	1	1	1	1	1	70

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha programet mbahet nga lënda Matematikë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **462** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarisë 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgata shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Mjekësisë	362	54	10	10	6	5	5	10	462
Programi Mjekësi e Përgjithshme	158	24	4	4	2	2	2	4	200
Programi Stomatologji	62	9	2	2	1	1	1	2	80
Programi Farmaci	38	6	1	1	1	1	1	1	50
Programi Infermieri	79	12	2	2	1	1	1	2	100
Fizioterapi dhe Rehabilitim	25	3	1	1	1	0	0	1	32

PROVIMI PRANUES

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme katër (4) vjeçare ose kanë kaluar me sukses testin e maturës shtetërore;

Për Programin Infermieri, kandidati duhet të ketë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë; Provimi pranues zhvillohet nga lëndët **Kimi** dhe **Biologji**.

X. FAKULTETI I ARTEVE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **186** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarisë 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgata shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Arteve të Bukura	148	18	5	6	0	3	3	3	186
<i>Departamenti i Arteve të Bukura</i>	53	7	4	2	0	1	1	1	69
<i>Programi Bachelor i Arteve Vizuale</i>	53	7	4	2	0	1	1	1	69
Specializimi Pikturë	13	1	1	0	0	1	0	0	16
Specializimi Skulpturë	6	1	0	0	0	0	0	0	7
Specializimi Grafikë	9	1	1	0	0		1	0	12
Specializimi Ilustrim dhe vizatim	7	1	1	0	0	0	0	0	9
Specializimi Arti konceptual dhe mediat e reja	7	1	0	1	0	0	0	0	9
Specializimi Dizajn Grafik dhe Multimedia	11	2	1	1	0	0	0	1	16

Departamenti i Artit Muzikor	47	5	0	0	0	1	1	1	55
Programi Bachelor i Muzikës në Performim	43	4	0	0	0	1	1	1	50
Specializimi Solo këndim	6	1	0	0	0	0	0	0	7
Specializimi Dirigjim	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Specializimi Piano	10	1	0	0	0	1	0	0	12
Specializimi Instrumente me harqe dhe tela	13	1	0	0	0	0	1	0	15
Specializimi Instrumentet frymore	13	1	0	0	0	0	0	1	15
Programi Baçelor i Muzikës	4	1	0	0	0	0	0	0	5
Specializimi Kompozimi	4	1	0	0	0	0	0	0	5
Departamenti i Arteve Dramatike	48	6	1	4	0	1	1	1	62
Programi i Arteve Dramatike	48	6	1	4	0	1	1	1	62
Specializimi Aktrim	7	1	1	0	0	1	0	0	10
Specializimi Dramaturgji dhe skenar filmi e tv	6	1	0	1	0	0	0	0	8
Specializimi Regji filmi dhe tv	7	0	0	0	0	0	0	0	7
Specializimi Regji teatri	5	1	0	0	0	0	0	0	6
Specializimi Dizajn skene dhe kostumografi	8	1	0	1	0	0	1	0	11
Specializimi Kamerë dhe montazh	8	1	0	1	0	0	0	0	10
Specializimi Produksion	7	1	0	1	0	0	0	1	10

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

BACHELOR (BA): Kërkesat dhe fazat e provimit pranues sipas specializimeve në Departamentin e Arteve të Bukura/Programi i Arteve Vizuale			
Studentët të cilët konkurrojnë në njërin prej specializimeve të Departamentit të Arteve të Bukura, Programi i Arteve Vizuale, duhet t'u nënshtrohen kritereve në vijim:			
SPECIALIZIMI: PIKTURË			
Faza e parë:			
1.	Provimi në vizatim:	Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore, duke u bazuar në modelin e gjallë.	
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Një pako letre ose kartoni (përmasa minimale 50cm x 70cm). Lapsa, thëngjill dhe mjete të tjera për vizatim.	
Faza e dytë:			
2.	Provimi në pikturë:	Kandidatët do të realizojnë një detyrë në pikturë.	
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Një pëlhurë (50cm x 70cm). Ngjyra vaji ose akrilik dhe mjete për pikturë.	
Faza e tretë:			
3.	Intervista dhe prezantimi i portfolios:	Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.	
	(Kërkesat për Portfolion):	Portfolio fizike:	Përmbajtja: 15 vepra origjinale (5 vizatime, 5 piktura, 5 skica konceptuale)/ Format: A3 Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës
		Portfolio digjitale:	Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none"> • Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike. • Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues. • Një ese prej 400 fjalësh me temën: “Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?” Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu gjatë aplikimit.

		Ese:	Një ese prej 400 fjalësh me temën: “Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?”
SPECIALIZIMI: SKULPTURË			
Faza e parë:			
1.	Provimi në vizatim:	Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore, duke u bazuar në modelin e gjallë.	
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Një pako letre ose kartoni (përmasa minimale 50cm x 70cm).	
		Lapsa, thëngjill dhe mjete të tjera për vizatim.	
Faza e dytë:			
2.	Provimi në skulpturë:	Kandidatët do të realizojnë një detyrë në skulpturë, duke përdorur materialet e ofruara nga fakulteti.	
	(Materialet e ofruara nga fakulteti):	Të gjitha materialet e nevojshme për provimin e Skulpturës.	
Faza e tretë:			
3.	Intervista dhe prezantimi i portfolios:	Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.	
	(Kërkesat për Portfolion):	Portfolio fizike:	Përmbajtja: 15 vepra origjinale (10 vizatime, 5 skica konceptuale)/ Formati: A3 Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës
		Portfolio digjitale:	Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none"> ● Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike. ● Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues. ● Një ese prej 400 fjalësh me temën: “Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?” Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu gjatë aplikimit.
SPECIALIZIMI: GRAFIKË			
Faza e parë:			

1.	Provimi në vizatim:	Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore, duke u bazuar në modelin e gjallë.	
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Një pako letre ose kartoni (përmasa minimale 50cm x 70cm). Lapsa, thëngjill dhe mjete të tjera për vizatim.	
Faza e dytë:			
2.	Provimi në grafikë:	Kandidatët do të realizojnë një detyrë kreative në fushën e grafikës.	
	(Materialet që studentët duhet t'i sjellin me vete në ditën e provimit):	Karton (përmasa minimale 50cm x 70cm). Ngjyra, tush dhe materiale të tjera përkatëse për grafikë.	
Faza e tretë:			
3.	Intervista dhe prezantimi i portfolios:	Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.	
	(Kërkesat për portfolion):	Portfolio fizike:	Përmbajtja: 15 vepra origjinale (5 vizatime, 5 grafika, 5 skica konceptuale)/ Format: A3 Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës
		Portfolio digjitale:	Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none"> ● Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike. ● Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues. ● Një ese prej 400 fjalësh me temën: “Cili është këndvështrimi juaj për rëndësinë e artit në shoqërinë bashkëkohore?” Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu gjatë aplikimit.
SPECIALIZIMI: ILUSTRIM DHE VIZATIM			
Faza e parë:			
1.	Provimi në vizatim:	Kandidatët do të vizatojnë portretin dhe figurën njerëzore, duke u bazuar në modelin e gjallë.	
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Vizatim: Një pako me letër ose karton (madhësia minimale 50cm x 70cm), lapsa, qymyr dhe materiale të tjera për vizatim.	

	ditën e provimit):	
2.	Ese:	Kandidatët duhet të shkruajnë gjatë provimit një ese prej 400 fjalësh për të dëshmuar njohuritë e tyre artistike.
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Ese: Letër të bardhë A4, laps
Faza e dytë:		
3.	Provimi në Ilustrim:	Kandidatët i nënshtrohen një provimi në lëndën e ilustrimit, duke përfunduar një detyrë krijuese.
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Një karton (madhësia minimale 50cm x 70cm) dhe ngjyrat e dëshiruara. Studentët janë të lirë të aplikojnë teknika të ndryshme dhe të përdorin materiale sipas zgjedhjes së tyre (kolazh, ngjyra sipas zgjedhjes së tyre, lapsa me ngjyra, akuarel, markerë, etj.).
Faza e tretë:		
4.	Intervista dhe prezantimi i portfolios:	Kandidatët do të paraqesin portfolion e tyre dhe do të intervistohen lidhur me punën e tyre krijuese, procesin krijues dhe vizionin artistik.
	(Kërkesat për Portfolion):	Portfolio fizike: Përmbajtja: 15 vepra origjinale (5 vizatime, 5 ilustrime, 5 skica konceptuale)/ Formati: A3. Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës.
		Portfolio digjitale:
SPECIALIZIMI: ART KONCEPTUAL DHE MEDIA TË REJA		
Faza e parë:		
1.	Provimi në art konceptual dhe media të reja:	Kandidatët i nënshtrohen një provimi në lëndën e artit konceptual dhe mediave të reja për të dëshmuar aftësitë e tyre artistike.
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Punë artistike: Një pako letër (madhësia minimale 50cm x 70cm), lapsa, thëngjill dhe ngjyrat që i preferojnë.

Faza e dytë:						
2.	Ese:	Kandidatët duhet të shkruajnë gjatë provimit një ese prej 400 fjalësh për të vlerësuar njohuritë dhe perspektivën e tyre mbi artin.				
	(Materialet që studentët duhet të sjellin me vete në ditën e provimit):	Ese: Letër të bardhë A4, laps				
Faza e tretë:						
3.	Intervista dhe prezantimi i portfolios:	Kandidatët do të prezantojnë portfolion e tyre dhe do të intervistohen për të diskutuar punimet, procesin krijues dhe vizionin e tyre artistik. Portfolio duhet të demonstrojë një gamë aftësish dhe të përfshijë skica fillestare për të dokumentuar zhvillimin e ideve të tyre.				
	(Kërkesat për Portfolion):	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 30%;">Portfolio fizike:</td> <td>Përmbajtja: 15 vepra origjinale (Fotografi, video, instalacione, ndërhyrje artistike ose skica konceptuale)/ Formati: A3. Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës.</td> </tr> <tr> <td>Portfolio digjitale:</td> <td> Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none"> ● Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike. ● Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues. Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu gjatë aplikimit. </td> </tr> </table>	Portfolio fizike:	Përmbajtja: 15 vepra origjinale (Fotografi, video, instalacione, ndërhyrje artistike ose skica konceptuale)/ Formati: A3. Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës.	Portfolio digjitale:	Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none"> ● Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike. ● Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues. Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu gjatë aplikimit.
Portfolio fizike:	Përmbajtja: 15 vepra origjinale (Fotografi, video, instalacione, ndërhyrje artistike ose skica konceptuale)/ Formati: A3. Vërejtje: Dorëzohet dhe prezantohet gjatë intervistës.					
Portfolio digjitale:	Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none"> ● Të njëjtat 15 vepra origjinale si në portfolion fizike. ● Skicat fillestare për të dokumentuar procesin krijues. Dorëzimi: Duhet të dërgohet në adresën artevizuale@uni-pr.edu gjatë aplikimit.					
SPECIALIZIMI: DIZAJN GRAFIK DHE MULTIMEDIA						
1.	Intervista:	<p>1. Prezantimi i shkurtër i kandidatit/tes (Bio): Një përshkrim i përgjithshëm dhe i strukturuar i historikut profesional dhe akademik të kandidatëve, duke përfshirë projektet e mëparshme, aftësitë dhe eksperiencat relevante në fushën e dizajnit grafik dhe multimedias.</p> <p>2. Arsyet për zgjedhjen e studimeve në specializimin "Dizajn Grafik dhe Multimedia": Kandidati/ja duhet të shpjegojë arsyet përse ka zgjedhur të ndjekë programin e studimeve bachelor në këtë fushë, si dhe synimet që ka për zhvillimin e aftësive të tij/saj në të ardhmen.</p> <p>3. Motivet që qëndrojnë pas zgjedhjes për të studiuar "Dizajn Grafik dhe Multimedia": Diskutimi i faktorëve personalë dhe profesionalë që e kanë nxitur kandidatin të zgjedhë këtë fushë dhe pse</p>				

		<p>programi i studimeve bachelor është hapi i duhur për zhvillimin e mëtejshëm të tij/saj.</p> <p>4. Shpjegimi i konceptit të punuar në fazën I: Kandidati/ja duhet të shpjegojë në detaje konceptin e zhvilluar gjatë fazës së parë të provimit, duke përfshirë procesin krijues, metodat e përdorura dhe implementimin e ideve të tij/saj.</p> <p>5. Prezantimi i portfolios dhe vizioni për zhvillimin krijues të aftësive të ardhshme: Kandidati/ja duhet të prezantojë portfolion e tij/saj dhe të diskutojë mënyrën se si e sheh zhvillimin e aftësive krijuese në të ardhmen, duke përfshirë qëllimet për avancimin e teknikave dhe eksperimentimin me stilin dhe mediat e reja.</p> <p>6. Preferencat për mediumet e artit dhe dizajnit, pasionet jashtë studimeve dhe burimet e inspirimit: Kandidati/ja mund të diskutojë mediumet që i preferon për krijimin e artit dhe dizajnit, pasionet jashtë studimeve dhe faktorët që e frymëzojnë dhe motivojnë për të krijuar punime të reja.</p>
2.	Portfolio fizike:	Portfolio fizike me punime të avancuara të kandidatëve duhet të dorëzohet gjatë intervistës (jo më shumë se 10 punime). Portfolio duhet të jetë në format A3 Portret dhe të përmbajë punime që reflektojnë aftësitë e zhvilluara dhe punë origjinale të kandidatëve.
3.	Portfolio digjitale dhe biografia:	Portfolio digjitale duhet të përmbajë portfolion e prezantuar në intervistë dhe një biografi të shkurtër (deri në 300 fjalë) që shpjegon rrugëtimin profesional dhe akademik të kandidatëve. Portfolio digjitale mund të përfshijë edhe punime dhe projekte të mëparshme që tregojnë aftësitë dhe vizionin e kandidatit. Portfolio digjitale dhe biografia duhet të ngarkohen në një platformë (shembuj: Wetransfer, Google Drive, Dropbox, etj.) dhe të dërgohen në email: arte@uni-pr.edu.

DEPARTAMENTI I MUZIKËS

KRITERET E PROVIMIT PRANUES NË NIVELIN BACHELOR

Programi i studimit : BACHELOR I MUZIKËS NË PERFORMIM

Vlerësimi i provimit pranues sipas këtyre kriterëve - BACHELOR

-Deri në 60% të pikëve arrihet: - (30% mesatarja e suksesit të shkollës së mesme dhe 30% i pikëve nga provimi i maturës).

-Deri në 40 % të pikëve nga provimi pranues (instrumentistet: instrumenti 20%, solfezh 10% dhe teori të muzikës 10% ; solo këndim: 20%- solo këndim; solfezh dhe teori të muzikës 10% dhe piano obligat 10%; dirigjim: 20%, harmoni dhe polifoni 10% dhe piano 10%; kompozim 20%, harmoni dhe polifoni 10% dhe piano 10%).

Specializimi PIANO

- Provim nga **lënda PIANO** (a)J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga WTC b)1 Vepër virtuoze; c) 1 Sonatë klasike (Beethoven, një kohë); d)1 Vepër madhore romantike;
- Provim nga lënda: **SOLFEZH**;
- Provim nga lënda **TEORI E MUZIKËS**;

Specializimi: INSTRUMENTET ME HARQJE DHE TELA

- Provim nga **instrumenti harkor përkatës** (a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b)1 Koncert (një kohë); c)1 Sonatë (një kohë); d) 1 Pjesë virtuoze;
- **KITARA** a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut (nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etidë nga op.6.dhe 29; c) 1 etidë përzgjedhje; d) 1 vepër ciklike:
- Provim nga lënda: **SOLFEZH**
- Provim nga lënda: **TEORI e MUZIKËS**.

Specializimi: INSTRUMENTET FRYMORE

- Provim nga lënda e **instrumenti frymor përkatës** (a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1Pjesë virtuoze;)
- Provim nga lënda: **SOLFEZH**
- Provim nga lënda: **TEORI e MUZIKËS**.

Specializimi SOLO KËNDIM

- Provim nga **SOLO KËNDIMI** (a) 2 Arie (nga repertori operistik);b) 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);
- Provim nga lëndët: **SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS**
- Provim nga lënda: **PIANO OBLIGAT**.

Specializimi: DIRIGJIM

- **Dirigjim i veprës** për orkestër, për solist ose vokalo instrumentale; (dirigjim publik ose DVD)

Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës.

Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.

- Provim nga lënda: **SOLFEZH**
- Provim nga lënda: **HARMONI**
- Provim nga lënda: **PIANO OBLIGAT**.

Programi i studimit - BACHELOR I MUZIKËS

Specializimi: KOMPOZIM

- Prezantimi i 3 kompozimeve të dorëzuara;
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lëndët: HARMONI - POLIFONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE DRAMATIKE

KRITERET E PROVIMIT PRANUES NË NIVELIN BACHELOR:

Programi i Arteve Dramatike

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Specializimi: Aktrim

Pjesa e parë e programit eliminues:

- Një recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një monolog nga dramaturgjia e autorëve - dramaturgëve botërorë dhe kombëtarë (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- Puna me mësimdhënës të caktuar,
- Verifikimi përfundimtar i aftësive.
- Të gjithë aplikantët lutën të sjellin fotografi "bust" në ditën e aplikimit.

Specializimi: Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqjeje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Specializimi: Regji Filmi dhe Televizioni

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të xhirojnë vetë në temën e dhënë (film tre minutash), të cilin e shfaqin para komisionit në finale.

Specializimi: Dramaturgjia dhe skenar filmi:

Zhvillimi i një skene dramatike përmes dialogut, me shkrim, sipas një rrethane të caktuar.

Përmbledhje (sinopsis) i një ngjarjeje të mundshme për një skenar filmi.

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga fusha e dramaturgjisë, kinematografisë dhe njohuri të përgjithshme.

Specializimi: Dizajn skene dhe Kostumografi

Faza e parë

- Kandidatët i nënshtrohen testimi nga njohuritë e vizatimit, duke realizuar portret, figurë sipas modelit, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e dytë

- Kandidatët i nënshtrohen testimi nga njohuritë e dizajnit të skenës dhe kostumeve, duke realizuar një detyrë kreative, përmes së cilës vlerësohen aftësitë artistike.

Faza e tretë

- Intervista dhe prezantimi i portofolios, i cili duhet të jetë si vijon: (Versioni fizik në formatin A3 dhe versioni soft në email adresën artevizuale@uni-pr.edu) me së paku 10-15 punime origjinale nga fusha e dizajnit të skenës dhe kostumeve, në të cilat mund të përfshijnë (vizatime, ilustrime, dizajne të skenës, dizajne të kostumeve dhe skica ideore).
Për të dokumentuar procesin kreativ, punimeve duhet t'iu bashkëngjiten edhe skicat fillestare.
- **Studentët, në ditën e provimit, duhet të marrin me vete një kanavacë të formatit 50x70cm, një pako letër të formatit 50x70cm dhe lapsin e thëngjillit dhe ngjyrat sipas dëshirës.**

Specializimi: Produksion

Faza e parë

Kandidatët që konkurrojnë në specializimin Produksion duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti, filmi, televizioni, radio dhe teatri.

Faza e dytë

Kandidatët, që kalojnë në pjesën e dytë, do t'i nënshtrohen provimit, duke shkruar një koncept - ide të një projekti teatror, filmik, televiziv apo artistik.

Faza e tretë

Kandidatët do të prezantojnë, mbrojnë projektin e tyre në fazën finale, në provim gojor, para komisionit.

Specializimi: Kamerë dhe Montazh

Kontrolli i plotësimit të kriterëve për specializimin e studimit për kandidatët “Kamerë dhe Montazh filmi” përbëhet nga dy pjesë:

1. Në pjesën e parë, të gjithë kandidatët i nënshtrohen:
 - Bërja e një testi të kulturës së përgjithshme.
 - Një provim me shkrim - analizë (maksimumi një faqe) e një filmi të shkurtër, i cili prezantohet nga komisioni vlerësues para kandidatëve rreth kuadrimit dhe montazhit.
 - Një provim gojor - një shtjellim i analizës me shkrim, si dhe pyetje nga fusha e filmit, TV.
2. Pas pjesës së parë, bazuar në rezultatet, komisioni vendos drejt përzgjedhjes së kandidatëve në një listë të shkurtër dhe kandidatët e përzgjedhur hyjnë në pjesën e dytë të procesit të përzgjedhjes:
 - Detyra praktike nga fusha e Kamerës dhe Montazhit të Filmit dhe TV, të prezantohet motivi me shkrim para komisionit, ide apo sinopsis në formë të shkruar, jo më i gjatë se një faqe.
 - Pastaj kandidati duhet ta realizojë filmin jo më të gjatë se 3min, pra xhirohet dhe montohet, detyra pastaj vlerësohet nga komisioni vlerësues.
 - Një provim gojor ku kandidati do ta mbrojë punimin e tij para komisionit vlerësues, nga specializimi Kamerë dhe Montazh.

Bazuar në rezultatet nga pjesa e parë dhe e dytë të kontrollit, komisioni rendit dhe zgjedh kandidatët që kanë të drejtën të regjistrohen në specializimin Kamerë dhe Montazh.

Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi, Dramaturgjia, Dizajn skene dhe Kostumografi, Produksion, Kamerë dhe Montazh

- Georg Sodull: “Historia e filmit”
- Abaz Hoxha: “Historia e filmit shqiptar”
- Luis Herman: Skenari i filmit dhe i televizionit
- Jezhi Plazhevski: Gjuha e filmit
- Fadil Hysaj: “Teatrollogji, dramaturgjia, regji dhe aktrim”
- Aristoteli: “Poetika”
- Vlladan Shvacov: “Bazat e dramaturgjisë”
- Dr. Nebi Islami: “Historia e dramës kombëtare 1886-1996”
- Dr. Josif Papagjoni: “Komedi që vjen nga skena”
- Eskili: “Orestia”
- Sofokli: Një tragjedi
- Aristofani: Një komedi
- Shekspiri: Një tragjedi
- Molieri: Një komedi
- Dramaturgjia nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
- Dramaturgjia bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.
- U. Gregor and E. Patalas: “History of Film”
- K. Raisz and G. Millar: “Film Editing”
- Marcel Martin: “The Language of Film”
- Jerzy Plazewski: “Jezik filma”
- Andre Bazin: “What is Cinema” (I, II, III, IV)

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **230** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandida të nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatën shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	182	24	5	5	5	2	2	5	230
Programi Prodhim Bimor	32	4	1	1	1	0	0	1	40
Programi Mjekësi Veterinare	31	4	1	1	1	1	0	1	40
Programi Ekonomi e Bujqësisë	31	4	1	1	1	0	1	1	40
Programi Teknologji Ushqimore me Bioteknologji	56	8	1	1	1	1	1	1	70
Programi Prodhim Shtazor	32	4	1	1	1	0	0	1	40

PROVIMI PRANUES

Në programin Mjekësi Veterinare, provimi pranues mbahet në lëndët: Kimi dhe Biologji, ndërsa për programet tjera, provimi mbahet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT - PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **100** studentë të rregullt:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandida të nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatën shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	79	11	2	2	2	1	1	2	100
Programi Edukim Fizik dhe Sport	79	11	2	2	2	1	1	2	100
Meshkuj	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Femra	32	4	1	1	1	0	0	1	40

Kandidatët, para aplikimit dhe/ose para pjesëmarrjes në provimin pranues, duhet të sjellin dëshmi për kontrollin e gjendjes psikosomatike, përkatësisht gjendjen shëndetësore, të folurit, të parit, të dëgjuarit dhe konstruksionin trupor.

Kontrolli mjekësor realizohet në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive, në Kampusin e QKUK-së.

PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e organizimit të provimit pranues është si në vijim:

1. Njohuritë lëvizore/sportive:

- Futboll: puna me top me këmbë dhe kokë;
- Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë;
- Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh;
- Volejbol: pasimi i topit në çifte me gishta dhe me parakrahë, gjuajtja dhe pranimi i topit;

2. Aftësitë lëvizore/motorike:

- Kërcimi nga vendi në gjatësi;
- Ngritja me forcë në hekur për meshkuj;
- Përkulje mbi krahë për femra;
- Vrapimi 100 m për meshkuj dhe femra;
- Bashkërendimi/koordinimi lëvizor;

3. Gjymnastikë sportive – lëvizje me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para dhe rrotullimi anësor në të dyja anët, përkatësisht “ylli”, për meshkuj dhe femra;

4. Not: demonstrimi i njërës nga teknikat e notit;

5. Agjilitet: T-testi;

6. Test me shkrim: ese e shkurtër deri në 150 fjalë.

Kriteret e poentimit përcaktohen në përputhje me aktet përkatëse të Universitetit të Prishtinës dhe rregullat e brendshme të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit, përfshirë dispozitat që ndërlidhen me procesin e studimeve për studentët sportistë të kategorizuar.

Kandidatët janë të obliguar që në ditën e provimit pranues të paraqiten me pajisje sportive përkatëse.

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **185** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandida të nga komunitetet joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvegja, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarisë 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgatara shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Edukimit	145	21	4	4	3	2	2	4	185
Departamenti i Edukimit Fillor	66	10	2	2	1	1	1	2	85
Programi Fillor	66	10	2	2	1	1	1	2	85
Departamenti i Edukimit në Fëmijëri të Hershme	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Programi Edukimi në Fëmijëri të Hershme (0-6 vjet)	47	7	1	1	1	1	1	1	60
Departamenti i Mësimdhënies në STEM	32	4	1	1	1	0	0	1	40
Programi Teknologjia Arsimore	32	4	1	1	1	0	0	1	40

PROVIMI PRANUES

Programi Fillor: 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;

Edukimi në fëmijëri të hershme (0-6 vjet): 1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike;

Teknologjia Arsimore: 1. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), 2. Matematikë, 3. Psikologji dhe shkathtësi analitike.

XIV. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **150** studentë të rregullt dhe atë në departamentin si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studi me të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci, Medvexha, 2%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Kandidatë nga Mali i Zi 1%	Kandidatë nga arbëresët e Italisë dhe arbëresët e Zarës 1%	Kandidatë nga shqiptarët e Turqisë 1%	Kandidatë nga mërgata shqiptare me origjinë nga Kosova 2%	Gjithsej
Fakulteti i Arkitekturës	118	18	3	3	2	2	2	2	150
Programi Arkitekturë	118	18	3	3	2	2	2	2	150

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga Matematika, Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë (sllajdi).

Për t'u pranuar, kandidati duhet të arrijë minimumi 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë së kandidatëve, të cilët aplikojnë në kuadër të kuotave të veçanta, të cilët duhet të arrijnë minimumi 20% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.